



AKT THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME "ROMANO-PORT" SH.A

Aksioneret themelues:

1. **Artan Dulaku**, i biri i Nikos i datelindjes 1965 lindur dhe banues ne Tirane , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

2. **Piro Bare**, i biri i Aleksit i datelindjes 1958, lindur dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

3. **Xhevat Rira**, i biri i Demiraliut i datelindjes 1946 lindur dhe banues ne Tirane , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Te quajtur me poshte "**Ortake Themelues**" ne perputhje me Ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregetar", vendosen te hartojne kete akt themelimi, si vijon:

NENI 1

FORMA DHE EMRI I SHOQERISE

Ortaket themelues formojne nje **shoqeri anonime pa oferte publike**, ne perputhje me Ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", kreu V, seksioni II, dhe Ligjin Nr.7667 dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregetar".

Emri i shoqerise eshte "**ROMANO-PORT**" SH.A.

Shoqeria me kete emer do te kete vulen e saj. Ne cdo akt te leshuar nga shoqeria eshte e detyrueshme te deklarohen inicialet "**sh.a**" (qe perfaqesojne tipin e shoqerise) dhe emri i shoqerise "**ROMANO-PORT**".

NENI 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise:

-Prodhim, eksport-import, tregtim te materialeve te ndertimit, si dhe te materialeve qe perdoren per industrine e naftes, gazit, ujit dhe minierave.

-Studim-projektim, ndertim te pontileve detare (skela) ne fushat hidro-termo-zhurme izolimeve.

-Kualifikim, trajnim te specialisteve projektues dhe zbatues te projekteve ne fushat e prodhimit te lendeve dhe materialeve te ndertimit, si dhe per realizimin e punimeve dhe ndertimeve ne sektoret e naftes, gazit dhe minierave.

-Veprimtari sipermarrje industriale, transport te mallrave dhe udhetareve.

-Krijimin e Agjensive te Transportit rrugor dhe ujqor nderkombetar per mallra e udhetare, Agjensive te Punesimit dhe Komisioneve te Ndermjetesimit.



-Krijimin e Agjensive dhe Instituteve per zbatim, kerkim e zhvillim te teknologjive te reja.

-Krijimin e linjave dhe njesive te vogla dhe te medha per prodhim dhe tregtim te energjise elektrike me burime natyrore dhe alternative.

-Importim-eksportim, tranzitim, ndermjetesim, furnizim me energji elektrike.

-Importim-eksportim dhe tregtim te linjave te prodhimit dhe teknologjive per prodhimin dhe shfrytezimin e burimeve energjitike.

-Shtypshkrime tipografike, postera, flete-palosje, shtepi botuese e shtypshkrim te ndryshme, si dhe tregtimi i tyre me shumice dhe pakice.

-Organizim seminaresh, konferencash nderkombetare, panairove, ekspozitave, manifestimeve kulturore dhe sportive.

NENI 3 SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne **qytetin e Duresit, Porto Romano**. Me miratimin e asamblese se jashtezakonshme ajo mund te cele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte Shqiperise.

NENI 4 KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **2 000 000 (dy milion) leke**, i ndare ne **2 000 (dy mije) aksione**. Vlera nominale e nje aksioni eshte **1 000 (nje mije) leke**.

KONTRIBUTET NE KAPITAL

- 1. Artan Dulaku**, zoterues i **666, aksioneve**, me vlere 1 000 leke nje aksion, e barabarte me **33. (tridhjete e tre) %** te kapitalit themeltar te shoqerise.
- 2. Piro Bare**, zoterues i **666, aksioneve**, me vlere 1 000 leke nje aksion, e barabarte me **33.(tridhjete e tre) %** te kapitalit themeltar te shoqerise.
- 3. Xhevat Rira**, zoterues i **668, aksioneve**, me vlere 1 000 leke nje aksion, e barabarte me **34 (tridhjete e kater) %** te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 5 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete mbi **20 vjet**. Si date fillimi do te jete data e regjistrimit te saj si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Personaliteti juridik fitohet qe nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar.



NENI 6
ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- I. **Asambleja e Aksionereve.**
-Asambleja e zakonshme.
-Asambleja e jashtezakonshme.
- II. **Keshilli Mbikqyres.**
- III. **Drejtori i Pergjithshem.**

Modalitetet dhe menyra e funksionimit te ketyre organeve do te percaktohet ne statut.

NENI 7
NDERTIMI DHE ORGANIZIMI I SHOQERISE

Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise "ROMANO-PORT" sh.a, zhvillohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar, ne baze te statutit te shoqerise dhe te ketij akti themelimi.

NENI 8

Pjese perberese e Aktit te Themelimit eshte Statuti i Shoqerise.

Ky Akt-Themelimi redaktohet ne pese kopje origjinale dhe nenshkruhet rregullisht, me vullnet te plote dhe personalisht nga themeluesit.

THEMELUESIT